



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organ Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENT" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 808/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të z. Agon Ramadani - Kryetar, znj. Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare, z. Vedat Poterqoi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Internat Security Association shpk", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të institucioneve komunale, ndërtesat e Administratës, Qendra për Punë Sociale, Arkivit të Qytetit, Shtëpisë së Kulturës", me nr. të prok: 613-22-5135-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK-Kuvendi Komunal Lipjan, me datën: 10.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Anulohet**, në tërësi, aktiviteti i prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të institucioneve komunale, ndërtesat e Administratës, Qendra për Punë Sociale, Arkivit të Qytetit, Shtëpisë së Kulturës", me nr. të prok: 613-22-5135-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/-"Kuvendi Komunal Lipjan"
- II.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- III.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.
- IV.** Me qenë se aktiviteti i prokurimit, i cekur në pikën I të këtij dispozitivi është anuluar në tërësi, i bëhet kthimi i mjeteve OE ankues "International Security Association" shpk.

Ar sy e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 16.12.2022, Komuna Lipjan, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të Kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi fizik i objekteve të institucioneve komunale, ndërtesat e Administratës, Qendra për Punë Sociale, Arkivit të Qytetit, Shtëpisë së Kulturës”, me nr. Prokurimit 613-22-5135-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Kuvendi Komunal Lipjan. Data e njoftimit për kontratë 10.06.2022, data e hapjes së ofertës 20.07.2022, data e Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues 19.08.2022 i pari, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i dyti 16.12.2023. Me datë 20.12.2022, Operatori Ekonomik International Security Association”sh.p.k, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Komuna Lipjan, me datë 21.12.2022, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin e datës 16.12.2022 të Autoritetit Kontraktues Komuna Lipjan.

Me datën 29.11.2022 Operatori Ekonomik “International Security Association” sh.p.k, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 808/2022, kundër njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedura të hapur, lloji i kontratës: Shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: 180,000.00 € vlere e madhe.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët me ç’rast AK është pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues, duke kërkuar që lënda të kthehet në rivlerësim e jo anulimin në tërësi të këtij aktiviteti të prokurimit, siç ka rekomanduar eksperti i jashtëm shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 10.01.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE "International Security Association" sh.p.k me seli në Prishtinë të aprohet si e bazuar.

- të anulohet ajtiviteti i prokurimit në tërësi

-Seanca dëgjimore

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar ne sqarimet e cekura me larte , Eksperti propozon OSHP-se qe ky aktivitet i prokurimit te Anulohet për tenderin Sigurimi fizik i objekteve të institucioneve komunale, ndërtesat e Administratës, Qendra për Punë Sociale, Arkivit të Qytetit, Shtëpisë së Kulturës nr. Prokurimit 613-22-5135-2-1-1 dhe nr. brendshëm 613 022 063 211, e ankesa e "International Security Association shpk" , ne tenderin e shpallur nga Kuvendi Komunal Lipijan me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të institucioneve komunale, ndërtesat e Administratës, Qendra për Punë Sociale, Arkivit të Qytetit, Shtëpisë së Kulturës" me nr. Prokurimit 613-22-5135-2-1-1 dhe nr. brendshëm 613 022 063 211, të cilësohet e bazuar.

-Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues

Paneli shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde si dhe faktet dhe në rrethanat e cituara si më sipër dhe veprimet e ndërmarra nga të dyja palët (OE dhe AK), duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë shkresave të lëndës, në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, PSH sqaron:

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues të paraqitura ne ankesën e tij kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, Paneli Shqyrtues konstaton se nuk ka qenë e mundur që ankesat e tyre të trajtohen në mënyrë meritore duke qenë se kemi pasur të bëjmë me dosje jo të përpiluar qartë, që përveç kundërthënies së saj me vlerën e parashikuar, PSH gjithashtu vlerëson që në po të njëjtën ka pasur lëshime të konsiderueshme në aspektin e përpilimit dhe qartësisë nga ana e AK në raport me palët e interesuara, andaj Paneli Shqyrtues konstatoi se zgjidhja më e mirë në këtë rast do të ishte anulimi i tërësishëm i këtij aktiviteti, si dhe në rast se AK ka interes që ta ri-tenderoj,

obligohet që lëshimet, kundërthëniet dhe paqartësitë të cilat do të cekim më poshtë ti përmirësoj, kështu duke mundësuar mundësi të barabartë për të gjithë ofertuesit e interesuar e gjithashtu duke devijuar mundësinë e diskriminimit të tyre në të ardhmen duke pasur parasysh qëllimin e kontratës.

Në pikën e mëposhtme që është pjesë e kërkesave në FDT, AK ka kërkuar si në vijim,

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar aktual dhe stafin profesional minimum 32 punëtorë

Dëshmia 2. Lista e stafit duhet të dorëzohet e nënshkruar dhe e vëlosur nga OE që duhet të përmbajë emrin, mbiemrin, profesionin dhe pozicionin. Për të gjithë stafin Kontratën e punës ose parakontratën për këtë projekt

Ndërsa në Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, është kërkuar si në vijim :

Operatori Ekonomik është i obliguar që në stafin e tij do të jenë të angazhuar për **Sigurimin fizik të objekteve të institucioneve komunale, ndërtesat e Administratës, Qendra për Punë Sociale, Arkivit të Qytetit, Shtëpisë së Kulturës** dhe kontratat e punëtorëve të jenë në kohëzgjatje prej 3 viteve, minimumi **16 punëtorë**.

Paneli Shqyrtues konstaton se, duke qenë se si kërkesa të tilla që bien në kundërshtim me njëra-tjetrën për faktin se tek kapaciteti teknik dhe profesional kërkohen min 32 ndërsa si dëshmi kontratat apo parakontratën për të gjithë stafin për këtë projekt, ndërsa tek aneksi 1 kërkohen min 16 punëtorë me kontrata të tyre në kohëzgjatje prej 3 viteve për këtë projekt, për më tepër lidhur me këtë, AK nuk ka sqaruar nëse kontratat e cekura Aneksi 1 kërkohen para lidhjes së kontratës me OE të rekomanduar apo të dorëzohen nga të gjithë OE së bashku me ofertën, kështu që në secilin rast kjo paqartësi do të mund të krijonte hapësirë për keqinterpretime, devijime, apo në rast sqarimesh edhe ndryshim material të ofertës, që decidivisht ndalohet me dispozitat e LPP-së, në andaj duke qenë si të tilla, PSH konstaton se në këtë rast është pamundësuar vlerësimi i qartë dhe subjektiv i kësaj ankese e sidomos se kërkesat e vendosura tek specifikimet teknike të detyrueshme për të cilat AK ka pohuar se kanë qenë kërkesa për të cilat mundet të kërkojë sqarime shtesë, kështu që, në rast të ritenderimit, konform LPP-së, mbetet në përgjegjësinë e AK-së që të hartojë dosje të qartë, me kërkesa të kuptueshme, dhe specifikimin e qartë të kërkesave kualifikuese dhe specifikave teknike të detyrueshme, në mënyrë që të përmbushet qëllimi i kontratës e gjithashtu

parimet themelore të LPP-së, në bazë të cilave duhet të sigurohet që asnjë palë e interesuar për pjesëmarrje të mos diskriminohet apo tu jepet mundësi eventuale favorizimi.

Paneli Shqyrtues në rastin konkret vlerëson se poashtu paga minimale e kërkuar nuk qëndron në harmoni me vlerën e parashikuar të kontratës, për faktin se në një kalkulim të thjeshtë të kësaj të fundit, sipas të dhënave të paraqitura në epokurimi, del që kërkesat lidhur me pagën minimale si dhe nëse shtojmë kontributet dhe tatimet e tyre, del të jetë pothuajse e pamundur realizimi i kësaj kontrate në këtë vlerë, ndërsa në anën tjetër kemi edhe OE të eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se kanë tejkaluar vlerën e parashikuar.

Andaj, PSH konstaton se hartimi i kësaj Dosje të tenderit ka qenë në kundërshtim me nenin 27 se LPP-së, paragrafi 1, e posaçërisht duke u mbështetur në nenin 47.14 i RRUOPP-së, i cili citon: *"Autoriteti kontraktues duhet të marrë një qasje të ngjashme jo-kufizuese kur zbulon se dosja e tenderit që ka lëshuar mund të ketë mangësi të caktuara ose mund të jetë më pak e qartë në disa pika. Kjo megjithatë nuk duhet që në asnjë rrethanë të çojë në ndonjë ndryshim de facto në kërkesat teknike dhe të tjera të dosjes së tenderit. Nëse autoriteti kontraktues vjen në përfundimin se tenderi i planifikuar është në fakt i papërshtatshëm atëherë ajo nuk do të jetë e mundur për të "riparuar" në dosjen e tenderit me anë të informacionit shtesë ose sqarime. Qasja e vetme në dispozicion në situata të tilla është që të anulohet tenderin dhe të fillojë një procedurë tjetër në bazë të një dosjeje të tenderit të ndryshuar.*

Për më tepër, vlen të theksohet se lidhur me këtë aktivitet prokurimi, pretendimet për afërsisht të njëjta janë shqyrtuar edhe më parë nga ana e këtij paneli, duke evidentuar parregullsitë e paraqitura dhe duke dhënë udhëzime drejtuar AK-së se si të veprohet në mënyrë që të mos veprohet ndesh me tiparet themelore të LPP-së, por nuk është dëshmuar nga ana e AK-së, bazuar në shkresat e lëndës se udhëzimet janë zbatuar, andaj përmes këtij vendimi, PSH lëshon vërejtje drejtuar AK-së që nëse në të ardhmen evidentohej veprime të tilla të njëjta apo të ngjashme, OSHP, në kuadër të Paneleve Shqyrtuese do të ndërmarrë veprimet e parashikuara me LPP për revokimin e certifikatës së prokurimit drejtuar zyrtarit përgjegjës.

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Agon Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna Lipjan

1x1OE "International Security Association" sh.p.k me seli në Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.